

PROCESVERBAL
nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 21.12.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: L Lazar Trajçev (mungesë me arsye).

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 40-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbali nga seanca e 9-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.12.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverblit nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.12.2023.
3. Propozim-plani vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2024.
4. Propozim-plani vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2024.
5. Propozim-program për punë i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 (me Propozim programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Propozim-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024).
6. Propozim-plani strategjik i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele 2024-2028.
7. Propozim-plani vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.
8. Propozim-plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 9-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.12.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.12.2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 3, 4 dhe 5

Z. Petrushevski sugjeroi, Propozim-plani vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2024, Propozim-plani vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative për vitin 2024 dhe Propozim-programi i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 (me Propozim-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Propozim – planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024) duhet të shpjegohen në një hyrje të përbashkët, dhe votimi duhet të bëhet për secilin pikë veç e veç.

Z. Trajçevski shpjegoi se Draft versionet e planeve vjetore për mbikëqyrje programore dhe administrative dhe Draft programi i punës së Agjencisë të gjitha për vitin 2024, Këshilli i miratoi në seancën e mbajtur më 10 nëntor. Në të njëjtën ditë u hap debat publik për të tre draft dokumentet që të mund të gjithë palët e interesuara të parashtronin sugjerimet dhe komentet e tyre. Në lidhje me Planin vjetor për mbikëqyrje programore nuk është dorëzuar asnjë koment dhe teksti që është propozuar tani si propozim është identik me atë që Këshilli ka miratuar në draft version. Ky plan përfshin të gjitha mbikëqyrjet e rregullta programore që Agjencia do të kryejë në vitin 2024. Në lidhje me Planin vjetor për mbikëqyrjen administrative, ai ka sqaruar se shënim ka dorëzuar vetëm Televizioni Koha nga Tetova, por ky shënim nuk mund të pranohet për arsye se këtë që kërkon transmetuesi, në vend që tri herë në vit në programin e saj të dhënat t'i publikojnë vetëm vetëm një herë në vit, nevojiten ndryshime në Ligjin për media, dhe jo ndryshime në Planin vjetor për mbikëqyrje administrative të Agjencisë. Gjatë debatit publik, nuk janë dorëzuar vërejtje për Programin e punës. Ndryshime në lidhje me Draft-versionin janë bërë vetëm në lidhje me periudhën kur duhet të kryhet aktiviteti për rinovimin e çertifikatës ISO 9001:2015, pra në vend të shtator-nëntorit, si periudhë për realizimin e këtij aktiviteti tani është caktuar muaji mars-gusht. Ndryshim është bërë edhe në Planin financiar, të cilin ai tha se do ta sqarojë më tej. Në programin e punës janë përcaktuar qëllimet që Agjencia planifikon t'i përmbushë në vitin e ardhshëm, si dhe aktivitetet konkrete që do të ndërmarrë për t'i përmbushur ato. Si aktivitete më domethënëse në vitin 2024, ai vuri në dukje procesin e hartimit të të gjitha dokumenteve dhe akteve nënligjore të parashikuara nga ndryshimet e fundit të LSHMAAV dhe monitorimin e pasqyrimin mediatik të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare. Me Propozim-planin financiar për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme janë planifikuar të arrijnë në 163.546.961,00 denarë. Propozimi është për 620.000,00 denarë më i lartë në lidhje me Draft-planin financiar, i cili ishte 162.926.961,00 denarë. Ndryshime janë bërë në anën e shpenzimeve në Planin-financiar, ku janë parashikuar fonde(mjete) për kontrollë sistematike të të punësuarve në Agjenci në vlerë prej 500.000,00 denarë dhe është

rritur shuma e fondeve synuar për riçertifikim të sistemit për udhëheqje me cilësi ISO (9001:2015) për 120.000,00 denarë. Me rishpërndarje mjetet për blerjen e pajisjeve për TIK u rritën nga 5.300.000,00 denarë në 5.640.000,00 denarë. Nga ana e të hyrave, shuma e mjeteve është rritur për 620.000 nga vitet e kaluara dhe tani arrin në 37.546.961,00 denarë. Ai shpjegoi se të gjitha pikat e tjerë në Planin financiar janë të njëjta në krahasim me draft-versionin dhe Propozimin e Planit financiar të propozuar për vitin 2024 është në vlerë më të madhe se plani financiar i miratuar për vitin 2023 që ishte 149.830.505,00 denarë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore në vitin 2024 vit , me tekstin e propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Planin vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative në vitin 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Programin e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024 (me Programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024), me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Programin e punës së mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-planin strategjik të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale 2024-2028. Ai shpjegoi se ky Plan strategjik është hartuar për të përcaktuar prioritetet dhe qëllimet drejt të cilave Agjencia do ta drejtojë punën e saj në pesë vitet e ardhshme. Ai tha Agjencia sipas Ligjit, nuk ka obligim të (sjellë)ketë Strategji, sepse ai obligim nuk ekziston. Këshilli ka miratuar Strategjinë 2019-2023 ku ka pasur plan veprimi për zbatimin e Strategjisë dhe ka paraparë aktivitete që duhet të ndërmarrin institucionet e tjera, por meqenëse nuk ekziston më strategji shtetërore, Agjencia nuk mund të urdhërojë institucionet e tjera shtetërore dhe nëse nuk duan mund të mos e zbatojnë Strategjinë e ASHMA-së. Për këtë arsye, kësaj radhe është hartuar Plani Strategjik me aktivitete vetëm të Agjencisë. Janë organizuar disa takime, biseda dhe debate publike me faktorët relevant (përkates) nga sfera mediatike, procesi u zhvillua në mënyrë transparente, të gjithë faktorët janë të njohur, versioni u është dorëzuar të gjitha subjekteve dhe anëtarëve të Këshillit. Janë identifikuar dy lloje qëllimesh: organizative dhe rregullative. Qëllimet organizative kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të Agjencisë dhe i referohen forcimit të mëtejshëm të profesionalizmit dhe njohurive të punonjësve, avancimit të proceseve të punës, avancimit të organizimit të brendshëm të Agjencisë dhe avancimit të bashkëpunimit me rregullatorë të mediave nga vendet e tjera. Qëllimet e rregullativës synojnë të përmirësojnë

disa aspekte të industrisë së medias. Bëhet fjalë për: avancimin e rregullativës mediatike, forcimin e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik, rritjen e konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së tregut mediatik, zhvillimin e mëtejshëm të arsimimit mediatik dhe inkurajimin e përfshirjes sociale, forcimin e vetërregullimit dhe bashkërregullimit, forcimin e mbrojtjes së audiencave së mitur (fëmijëve) dhe transparencën e pronësisë së medias. Gjatë përcaktimit të qëllimeve strategjike janë shfrytëzuar njohuritë nga analizat, studimet dhe raportet e Agjencisë, si dhe analizat dhe hulumtimet përkatëse të subjekteve të tjera, si dhe janë shfrytëzuar edhe organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e medias dhe mediat janë konsultuar dhe gjatë përgatitjes së Planit strategjik. Duke qenë se projekti IPA për harmonizimin e legjislacionit nuk është zbatuar plotësisht, pas mbarimit të procesit zgjedhor do të ketë ndryshim në një ligj që është aktualisht në parlament dhe nuk dihet se si do të jetë versioni përfundimtar. Ai shpjegoi se nëse miratohen këto rregullore të duhura ligjore, dhe ky Plan strategjik i propozuar do të pësojë ndryshime të duhura.

Z. Petrushevski shpjegoi se e ka lexuar Propozim-planin strategjik dhe tha se dokumenti është punuar me cilësi dhe ajo që i pëlqen është që qëllimet e deklaruara janë konkrete dhe të qarta. Ai tha se dokumenti është i shkurtër që është mirë dhe rekomandohet që këto lloj dokumentesh të jenë 30-40 faqe, çdo fjalë të jetë e qëndrueshme dhe e gjithë kjo është zbatuar në dokumentin e propozuar. Ai gjithashtu përmban dhe informacion se strategjia e mëparshme është pothuajse plotësisht e realizuar. Ai deklaroi se do ta mbështesë plotësisht këtë strategji për 5 vitet e ardhshme.

Z. Fidanoski tha se pajtohet me titullin e dokumentit, gjegjësisht se “Plani Strategjik” në këtë moment është më i përshtatshëm se “Strategjia”. Ai bën të ditur se gjatë përgatitjes ka pasur biseda me shërbimin profesional dhe praktikisht së bashku janë pajtuar që ky titull është më i mirë. Siç tha z. Trajçevski, Agjencia nuk ka obligim për përgatitjen e strategjive, por Agjencia i bën sepse është profesionalisht e vendosur për të kryer punën e saj. Siç tha edhe më parë, mendon se është më mirë në titull të thuhet “Plani Strategjik”, dhe “Strategjia” do të diskutohet në atë moment kur dhe institucionet në vend do të guxojnë të bëjnë një strategji kombëtare mediatike që duhet të përcaktojë të paktën drejtimet afatmesme, sepse në afat të gjatë nuk mund të bëhet fjalë për shkak të progresit qytetar që shumë shpejt reflektohet dhe në sferën mediatike. Për të, dokumenti është i përgatitur shumë mirë, ai harton situatën, por edhe sfidat e ardhshme në fushën e medias nga pikëpamja rregullatore. Fokusi parësor janë kompetencat e reja të shtuara që ka rregullatori me ndryshimet ligjore, të cilat janë rezultat i zbatimit të direktivës së rishikuar audiovizuale dhe dokumenteve të tjera që po përgatiten në nivel evropian dhe që duhet të miratohen. Praktikisht me këtë plan strategjik, Agjencia përfshin dhe ata që në të ardhmen duhet të jenë pjesë e sistemit tonë legjislativ në lidhje me median. Rregullatori ka kompetenca të reja të shtuara me këto ndryshime ligjore, detyrime të shtuara, por edhe sfida për të vazhduar me kohën e përparimit civilizues siç është p.sh inteligjenca artificiale. Ai shpreson që shteti do të guxon, do të tregojë gatishmëri dhe motivim që sa më shpejtë të përgatisë një Strategji kombëtare për sferën mediatike. Deri atëherë, Agjencia si rregullator do të përfundon pjesën e saj të punës dhe është e gatshme, nëse është e nevojshme, si rregullator të ofrojë ndihmë profesionale në hartimin e kësaj strategjie që ajo t'i ketë të gjitha elementet që duhet t'i përmbajë një strategji kombëtare e suksesshme. Vizioni dhe misioni në këtë dokument është i mirë përcaktuar dhe dy qëllime rregullatore, të cilat sipas tij janë jashtëzakonisht të rëndësishme janë forcimi i kapaciteteve të ASHMA-së dhe avancimi i rregullativës mediatike, i cili do të sigurojë parakushte për zbatimin e të gjitha qëllimeve të tjera që janë të shkruara në këtë plan strategjik. Ai beson se avancimi i kësaj rregullative mediatike do të ecë me ritme të mira dhe paralajmëroi se do ta mbështesë këtë plan.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Planin Strategjik të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën 2024-2028, me tekstin e propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin strategjik ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozim-planin vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024. Ajo shpjegoi se në pajtim me Strategjinë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konflikt interesi për vitin 2021-2025 miratuar nga komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Agjencia, duke filluar nga viti 2021, fillon të realizojë Planet vjetore për parandalimin e korrupsionit. Ky plan i propozuar përmban një sërë masash, aktivitete, njësi organizative kompetente, përkatësisht personin e caktuar, afatin e zbatimit, treguesit për përmbushje, implikimet financiare për realizimin e aktiviteteve me qëllim të zbatimit të masave. Të gjitha këto deklarata janë të përfshira në planin e veprimit, i cili është pjesë përbërëse e Planit Vjetor. Plani është konceptuar në mënyrë që janë hartuar disa pjesë të ndjeshme ndaj korrupsionit, si furnizimi publik, zbatimi i buxhetit dhe zbatimi i procedurave, veprim sipas raporteve të sinjalizuesve, procedurat për aksesin në informacione me karakter publik, planifikimi dhe menaxhimi financiar, politika kuadrore, profesionale dhe sjellja etike e punonjësve, kryerja e mbikëqyrjes. Ky plan vjetor përmban edhe një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara dhe masave të ndërmarra nga Agjencia për t'u zbatuar në vitin 2023.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që Drejtori i Agjencisë të miratojë Planin vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për vitin 2024 ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozim-planin vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024. Ajo shpjegoi se duke filluar nga viti 2022, Agjencia sjell një plan të tillë vjetor. Plani i propozuar përmban një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara dhe masave të zbatuara të Agjencisë me qëllim për zbatimin e planit të veprimit të përfshirë në planin vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Nëse bëhet inspektimi i këtyre aktiviteteve, do të konstatohet se të gjitha aktivitetet që ishin paraparë në planin për vitin 2023 janë realizuar, që do të thotë se Agjencia ka vepruar, gjegjësisht i ka realizuar të gjitha aktivitetet. Në Plan janë identifikuar të gjitha fushat që mund të jenë të ndjeshme ndaj korrupsionit në kuadër të fushëveprimit të punës së Agjencisë, dhe si të tilla janë renditur 5 fushat prioritare ku më së shpeshti ekziston rreziku i korrupsionit - integriteti individual dhe institucional, cilësia e punës në Agjenci, duke vepruar sipas raportimeve për parregullsi dhe raportimeve nga sinjalizues, furnizim publik dhe konfliktit të interesave gjatë zbatimit të mbikëqyrjes. Nëpërmjet planit të veprimit për vitin 2024, që është pjesë përbërëse e këtij plani,

jipet një pasqyrë e rrezikut, aktiviteteve, masave, bartësve, përkatësisht njësive organizative kompetente, afatit të zbatimit, implikimeve financiare, vlerësimit të rrezikut, për realizimin e veprimtarive.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të miratojë Planin vjetor të vlerësimit të rreziqeve të Korrupsionit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit të Agjencisë për vitin 2024 ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 9

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4655

26.12.2023

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI